

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.125/2013, “PËR KONCESIONET DHE PARTNERITETIN PUBLIK PRIVAT”, TË NDRYSHUAR

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ky projektligj është një iniciativë ligjore e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, e cila ka në fushën e përgjegjësisë orientimin dhe harmonizimin e veprimtarisë për zhvillimin e koncesioneve/PPP, por njëkohësisht dhe hartimin e politikave për miradministrimin e buxhetit, në të cilat përfshihen planifikimi dhe zbatimi i buxhetit, programimi strategjik dhe monitorimi i investimeve publike, monitorimi i marrëdhënieve financiare ndërqeveritare, kontrolli financiar i transaksioneve publike dhe hartimi i pasqyrave financiare të konsoliduara të qeverisë.

Nëpërmjet këtij projektligji synohet heqja e mundësisë së zhvillimit të projekteve të koncesioni/PPP, në formën e propozimeve të pakërkuara nga sektori privat, për një sërë sektorësh. Konkretisht, me anë të këtij projektligji është propozuar që nga data 1 korrik 2019 të lejohen propozimet e pakërkuara vetëm për realizimin e punimeve dhe/ose ofrimin e shërbimeve në porte, aeroporte, për prodhimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike, energjisë për ngrohje dhe shpërndarjen e gazit natyror.

Gjithashtu, ky projektligj përcakton shprehimisht që pas datës 1 korrik 2019 nuk do të jetë më e mundur të propozohen nga sektori privat projekte koncesioni/PPP, në formën e propozimit të pakërkuar për ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e rrugëve nacionale me rëndësi të veçantë. Pas datës së sipërcituar, këto projekte do të zhvillohen sipas procedurave dhe rregullave të përcaktuara në ligjin nr.125/2013 dhe jo me procedurë të veçantë, siç trajtohen aktualisht.

Një parashikim tjetër i këtij projektligji është edhe shfuqizimi i sistemit të shpërblimit me pikë bonus të propozuesve të pakërkuar dhe zëvendësimi i tij me mekanizmin e kompensimit, i cili konsiston në kompensimin në vlerë monetare për shpenzimet e kryera për përgatitjen e studimit të fizibilitetit nga propozuesi i pakërkuar, në rast se ky i fundit nuk shpallet fitues.

Heqja e sistemit të bonusit dhe përfshirja e projekteve të koncesionit për ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e rrugëve nacionale me rëndësi të veçantë, brenda fushës së përgjegjësisë së këtij ligji bëhet në përputhje me rekomandimet e Komisionit Evropian dhe direktivën 2014/23 UE “Për dhënien e kontratave të koncesionit”.

Gjithashtu, me anë të ndryshimeve të propozuara në këtë projektligj synohet të rritet kontrolli i ministrisë përgjegjëse për financat jo vetëm gjatë fazës së përgatitjes së projekteve të koncesionit/PPP, por edhe gjatë zbatimit të kontratave të koncesionit/PPP, për të mbajtur nën kontroll angazhimet fiskale të marra përsipër nga autoritetet kontraktuese me qëllim minimizim e impaktit të tyre në buxhet.

Nisur nga fakti që kontratat e koncesionit/PPP janë afatgjata (me një afat që shkon maksimalisht 35 vjet) dhe përmbajnë risqe të shumta ku një pjesë e tyre janë mbajtur nga autoritetet kontraktuese, është i domosdoshëm edhe monitorimi i këtyre risqeve nga ana e ministrisë përgjegjëse për financat në rolin e autoritetit përgjegjës për monitorimin dhe menaxhimin e risqeve buxhetore.

Për të eliminuar çdo implikim të paparashikuar të buxhetit të shtetit si rrjedhojë e angazhimeve financiare të pakontrolluara nga ana e autoriteteve kontraktuese dhe me qëllim që ministria përgjegjëse për financat të jetë në dijeni të të gjithë ecurisë së projekteve dhe kontratave të koncesionit/PPP, është e domosdoshme përfshirja në ligj edhe e parashikimeve mbi raportimin e ecurisë së këtyre kontratave.

Në këtë projektligj është parashikuar edhe krijimi i një organi kolegjal, Komiteti i Përzgjedhjes së Projekteve të Koncesionit/PPP, i cili do të përzgjedhë projektet e koncesionit/PPP të cilat do të asistohen me ekspertizë të specializuar, për hartimin e studimeve të fizibilitetit dhe/ose oponencën e tyre, duke i dhënë kështu një mundësi autoriteteve kontraktore që të kërkojnë mbështetje për zhvillimin e projekteve me ekspertizë të specializuar. Ndryshimi i kuadrit institucional i parashikuar në këtë projektligj do të sjellë përgatitjen me cilësi të studimit të fizibilitetit i cili përbën thelbin e rezultateve dhe suksesit të një projekti koncesioni/PPP, sikurse dhe mbështetjen me ekspertizë të specializuar për t’u bërë oponencë propozimeve të pakërkuara në sektorët në të cilët do të lejohet paraqitja e propozimeve të pakërkuara.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektligji nuk është parashikuar në programin analitik të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Synimi i projektligjit është të përmirësojë kuadrin ligjor dhe mënyrën e zbatimit të procedurave për dhënien e koncesioneve/PPP duke sjellë këto risi kryesore:

a) Heqjen e propozimeve të pakërkuara në një sërë sektorësh.

Referuar rekomandimeve të institucioneve të ndryshme ndërkombëtare, si FMN, Banka Botërore, SIGMA-OECD dhe duke marrë shkas se tendenca e shteteve ndërkombëtare gjatë viteve të fundit është ajo e reduktimit të propozimeve të pakërkuara kemi propozuar kufizimin e së drejtës së identifikimit e të zhvillimit të propozimeve të projekteve të koncesionit/PPP, nëpërmjet propozimeve të pakërkuara nga sektori privat. Konkretisht, me anë të këtij projektligji është propozuar që nga data 1 korrik 2019 të lejohen propozimet e pakërkuara vetëm për realizimin e punimeve dhe/ose ofrimin e shërbimeve në porte, aeroporte, për prodhimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike, energjisë për ngrohje dhe shpërndarjen e gazit natyror.

Sa më sipër, duke marrë në konsideratë se sektori i energjisë, portet dhe aeroportet mbeten sektorë strategjikë dhe për këtë arsye është parashikuar mundësia e lejimit të propozimeve të pakërkuara nga operatorët privatë vetëm në këto sektorë.

Gjithashtu, ky projektligj përcakton shprehimisht që pas datës 1 korrik 2019 nuk do të jetë më e mundur të propozohen nga sektori privat projekte koncesioni/PPP, në formën e propozimit të pakërkuar për ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e rrugëve nacionale me rëndësi të veçantë. Pas datës së sipërpërmendur, këto projekte do të zhvillohen sipas procedurave e rregullave të përcaktuara në ligjin nr.125/2013 dhe jo me procedurë të veçantë, siç trajtohen aktualisht.

b) Heqjen e bonusit për propozimet e pakërkuara.

Me anë të këtij projektligji do të hiqet sistemi i shpërblimit të propozuesve të pakërkuar me pikë bonus. Për të nxitur sektorin privat për të propozuar projekte të studiuara duke përdorur kapacitetet dhe eksperiencën e tyre, është propozuar zëvendësimi i sistemit me pikë bonus me atë të kompensimit në vlerë monetare të propozuesit të pakërkuar, në rast se ky i fundit nuk shpallet fitues. Në çdo rast, vlera e kompensimit nuk mund të jetë më e lartë se 1% e vlerës së

investimit. Mekanizmi i propozuar i kompensimit nuk cenon konkurrencën dhe nuk avantazhon propozuesin e pakërkuar.

c) Forcimin e rolit të ministrisë përgjegjëse për financat.

Qëllimi i këtij projektligji është përcaktimi i qartë i rolit dhe përgjegjësi të ministrisë përgjegjëse për financat në lidhje me vlerësimin, miratimin e projekteve të koncesionit/partneritetit publik privat dhe ecurinë e kontratave të koncesionit/PPP nga pikëpamja e implikimeve fiskale, individuale apo në grup për shpenzimet buxhetore, deficitin buxhetor, qëndrueshmërinë e borxhit publik dhe detyrimet kontingjente eventuale.

Gjithashtu, edhe misionet e ndryshme të Bankës Botërore dhe të FMN-së gjatë takimeve të tyre përgjatë vitit 2017 të zhvilluara pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe institucioneve të ndryshme shtetërore kanë dhënë rekomandimet e tyre nëpërmjet raporteve zyrtare në lidhje me nevojën e madhe të forcimit të rolit të ministrisë përgjegjëse për financat, në lidhje me projektet dhe kontratat e koncesionit/PPP, si burime të riskut fiskal.

Duke qenë se projektet e koncesionit/PPP janë projekte komplekse, afatgjata që implikojnë një sërë risqesh, si dhe detyrimesh kontingjente të konsiderueshme për buxhetin e shtetit, është e nevojshme dhe e domosdoshme që të gjitha këto projekte si ato me dhe pa mbështetje financiare të paraqiten paraprakisht në ministrinë përgjegjëse për financat për vlerësim dhe miratim në këndvështrimin e implikimeve fiskale dhe buxhetore.

Këto ndryshime vijnë gjithashtu në harmoni dhe koherencë të plotë me ligjin organik nr.9936/2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, konkretisht përcaktohet se:

“...Ministria e Financave vlerëson dhe miraton paraprakisht të gjitha projektet koncesionare dhe të partneritetit publik privat (PPP), si edhe çdo ndryshim të tyre, nga pikëpamja e implikimeve, individuale apo në grup, për shpenzimet buxhetore, deficitin buxhetor, qëndrueshmërinë e borxhit publik dhe detyrimet kontingjente eventuale. Shuma e përgjithshme e pagesave vjetore neto, që kryhen nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, të cilat rezultojnë nga kontrata koncesionare apo partneriteti publik privat (PPP), si rregull, nuk duhet të tejkalojnë kufirin prej 5 për qind të të ardhurave tatimore faktike të vitit paraardhës buxhetor. Në rast tejkalimi të këtij kufiri, Këshilli i Ministrave merr masa korrektuese në krahun e të ardhurave buxhetore, të nevojshme dhe të mjaftueshme për t’u rikthyer brenda kufirit të lejuar, gjatë dy viteve të ardhshme buxhetore. Kuvendi, në ligjin vjetor të buxhetit, miraton tavanin e vlerës totale të kontratave në përqindje të Produktit të Brendshëm Bruto (PBB), për të gjitha projektet koncesionare/PPP-të ekzistuese dhe ato të kontraktuara rishtazi gjatë vitit buxhetor korrent.”.

Gjithashtu, duke marrë shkas nga numri relativisht i lartë i kontratave të koncesionit/PPP, rreth 217 sipas regjistrit elektronik të koncesionit/PPP, të publikuar në faqen zyrtare të Agjencisë së Trajtimit të Koncesioneve, është i nevojshëm edhe monitorimi nga ana ministrisë përgjegjëse për financat në aspektin e implikimeve financiare gjatë zbatimit të këtyre kontratave.

Momentalisht, ministria përgjegjëse për financat nuk merr nga autoritetet kontraktuese dhe si rrjedhojë nuk shqyrton raporte mbi performancën dhe ecurinë e kontratave të koncesionit/PPP. Menaxhimi i riskut fiskal kërkon një vlerësim periodik të performancës së kontratave. Në rastin e performimit të dobët të kontratave, është e nevojshme marrja e masave të menjëhershme, për minimizimin e kostove fiskale. Ministria përgjegjëse për financat duhet të jetë e informuar në lidhje me risqet e kontratave koncesionare/PPP-ve, për të analizuar dhe minimizuar risqet e tyre fiskale dhe buxhetore.

Për të eliminuar çdo implikim të paparashikuar të buxhetit të shtetit si rrjedhojë e angazhimeve financiare të pakontrolluara nga ana e autoriteteve kontraktuese dhe me qëllim që ministria përgjegjëse për financat të jetë në dijeni të të gjithë ecurisë së projekteve dhe kontratave të koncesionit/PPP, është e domosdoshme parashikimi në ligji i dispozitave në lidhje me monitorimin e tyre.

Gjithashtu, referuar ligjit aktual të koncesioneve/PPP nr.125/2013, autoritetet kontraktuese e dërgojnë paraprakisht për vlerësim dhe miratim në ministrinë përgjegjëse për financat studimin e fizibilitetit dhe projektkontratën, por që me marrjen e këtij miratimi nuk kanë më asnjë detyrim për të informuar ministrinë në lidhje me angazhimet e negociuara dhe të kontraktuara me operatorin e shpallur fitues. Për këtë arsye ministria e financave duhet të informohet paraprakisht për të gjitha angazhimet dhe risqet e marra përsipër nga palët përpara nënshkrimit të kontratës së koncesionit/PPP, të cilat fare lehtë mund të ekspozojnë buxhetin e shtetit në mënyrë të pakontrolluar ndaj risqeve potenciale fiskale.

Kështu, për të shmangur çdo dyshim dhe çdo kosto shtesë, si rrjedhojë e vënies në zbatim të këtyre projekteve të koncesionit/PPP, është e domosdoshme që çdo ndryshim si gjatë fazës së përgatitjes së projekteve (në studim fizibilitetit), por edhe pas nënshkrimit të kontratës, (kontrata e koncesionit/PPP), duhet të vlerësohet dhe të miratohet paraprakisht nga ministria përgjegjëse për financat.

Një parashikim tjetër që vlerësohet shumë i rëndësishëm është që përpara nënshkrimit të kontratës përfundimtare të koncesionit/PPP, kjo kontratë të paraqitet sërish për vlerësim pranë ministrisë përgjegjëse për financat, me qëllim verifikimin nëse autoritetet kontraktuese pas negociimit të saj i janë përmbajtur vlerësimeve dhe rekomandimeve të dhëna nga ministria përgjegjëse për financat.

Duke qenë se kontratat e koncesionit/PPP janë angazhime afatgjata dhe klasifikohen si burime të konsiderueshme risku që mund të ndikojnë në GDP-në e një vendi, është e nevojshme që këto kontrata dhe çdo ndryshim i tyre të kalojnë një sërë filtrash që nga vlerësimi dhe miratimi ministrisë përgjegjëse për financat nga pikëpamja e implikimeve fiskale, individuale apo në grup për shpenzimet buxhetore, deficitin buxhetor, qëndrueshmërinë e borxhit publik dhe detyrimet kontingjente eventuale deri te miratimi përfundimtar i çdo kontrate me vendim të Këshillit të Ministrave.

ç) Komiteti i Përzgjedhjes së Projekteve të Koncesionit/PPP.

Komiteti i Përzgjedhjes së Projekteve të Koncesionit/PPP do të jetë një organ kolegjal me objekt kryesor të veprimtarisë përzgjedhjen e projekteve të koncesionit/PPP të cilat do të asistohen me ekspertizë të specializuar për hartimin e studimeve të fizibilitetit.

Kjo strukturë do të koordinohet së bashku me ATRAKO-n, i cili do të analizojë kërkesat e autoriteteve kontraktuese për mbështetje me ekspertizë të specializuar dhe do t'i propozojë ato për miratim Komitetit.

Krijimi i kësaj strukture do të eliminojë përfundimisht nevojën për ekspertizë nga sektori privat për hartimin e propozimeve të pakërkuara, do të rrisë ndjeshëm cilësinë e studimeve duke pasqyruar në mënyrë të pavarur të gjitha elementet e tij. Kostot për kontraktimin e ekspertëve do të përballohen nga donatorë të ndryshëm vendas dhe të huaj, buxheti i shtetit si dhe nga tarifa e cila do të mblidhet nga operatorët fitues për shërbimin e ofruar.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, ky projektligj propozohet nga Këshilli i Ministrave.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS

Ky projektligj nuk synon përafrimin me direktivat e BE-së.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Akti është i hartuar në 18 nene ku janë pasqyruar shtesat dhe ndryshimet në ligjin bazë konkretisht:

Në nenin 1 të projektligjit është bërë zëvendësimi i emërimit “Njësia e Trajtimit të Koncesioneve dhe Partneriteteve Publike Private” me “Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve (ATRAKO)”.

Në nenin 2 të projektligjit është shfuqizuar dispozita e cila përjashtonte nga fusha e zbatimit të këtij ligji koncesionet e punëve publike për ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e rrugëve nacionale kur ato paraqesin rëndësi të veçantë për infrastrukturën rrugore të vendit. Në këtë mënyrë, pas datës 1 korrik 2019, projektet e koncesionit të punëve publike për ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e rrugëve do të trajtohen sipas dispozitave të ligjit nr.125/2013, “Për koncesionet/PPP”.

Në nenin 3 të projektligjit janë përcaktuar roli dhe përgjegjësitë e ministrisë përgjegjëse për financat.

Me qëllim harmonizimin e këtij ligji me parashikimet e ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën Shqipërisë”, të ndryshuar, i cili shtrinë efektet e kontrollit të ushtruar nga ministria përgjegjëse për financat jo vetëm në kontratat e koncesionit/PPP me mbështetje financiare por kërkon një vlerësim dhe miratim të gjitha projektet koncesionare dhe të partneritetit publik privat (PPP), nga pikëpamja e implikimeve, individuale apo në grup, për shpenzimet buxhetore, deficitin buxhetor, qëndrueshmërinë e borxhit publik dhe detyrimet kontingjente eventuale.

Ky kontroll duhet të ushtrohet nga ministria jo vetëm në fazën e përfundimit të studimit të fizibilitetit, por edhe në fazën përfundimtare atë të nënshkrimit të kontratës së koncesionit.

Konkretisht, ministria përgjegjëse për financat do të vlerësojë dhe do të miratojë paraprakisht të gjitha projektet e koncesionit/partneritetit publik privat dhe ecurinë e kontratave të koncesionit/PPP nga pikëpamja e implikimeve fiskale, individuale apo në grup për shpenzimet buxhetore, deficitin buxhetor, qëndrueshmërinë e borxhit publik dhe detyrimet kontingjente eventuale.

Në nenin 4 të projektligjit është riformuluar dispozita e cila parashikon ndër detyrat e Agjencisë së Prokurimit Publik përjashtimin e operatorëve ekonomikë nga përfitimi i kontratave publike, për të gjitha rastet e parashikuara në legjislacionin e prokurimit publik.

Në nenin 5 të projektligjit është parashikuar se Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve do të analizojë kërkesat e autoriteteve kontraktore për mbështetje me ekspertizë të specializuar për hartimin e studimeve të fizibilitetit ose për kryerjen e opionencës së propozimeve të pakërkura dhe t’ia propozojë për

miratim Komitetit të Përzgjedhjes së Projekteve të Koncesionit/PPP. Fondet për kontraktimin e ekspertëve do të sigurohen nga buxheti i shtetit, donatorë të ndryshëm dhe tarifatat që do të paguheshin nga operatorët fitues për shërbimin e konsulencës. Procedurat për përzgjedhjen e ekspertëve do të kryhen në përputhje me rregullat e prokurimit publik.

Në nenin 6 të projektligjit është parashikuar krijimi i një strukture të veçantë, **Komiteti i Përzgjedhjes së Projekteve të Koncesionit/PPP**, i cili do të ketë objekt kryesor të veprimtarisë përzgjedhjen e projekteve të koncesionit/PPP të cilat do të asistohen me ekspertizë të specializuar për hartimin e studimeve të fizibilitetit dhe/ose për kryerjen e oponencës së tyre.

Kjo strukturë do të koordinohet së bashku me ATRAKO-n, i cili do të analizojë kërkesat e autoriteteve kontraktuese për mbështetje me ekspertizë të specializuar dhe do t'i propozojë ato për miratim Komitetit.

Krijimi i kësaj strukture do të eliminojë përfundimisht nevojën për ekspertizë nga sektori privat për hartimin e propozimeve të pakërkuara, do të rrisë ndjeshëm cilësinë e studimeve duke pasqyruar në mënyrë të pavarur të gjitha elementet e tij. Kostot për kontraktimin e ekspertëve do të përballohen nga donatorë të ndryshëm vendas dhe të huaj, buxheti i shtetit si dhe nga tarifa e cila do të mblidhet nga operatorët fitues për shërbimin e ofruar.

Në nenin 7 të projektligjit është përcaktuar procedura dhe mënyra e aplikimit për të kërkuar mbështetjen me ekspertizë të specializuar për përgatitjen e studimit të fizibilitetit dhe/ose oponencën e tyre. Rregullat më të hollësishme në lidhje me këtë procedurë do të përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Në çdo rast, për projektet me vlerë mbi 100 000 000 euro autoritetet kontraktuese i drejtohen Komitetit, për mbështetje me ekspertizë.

Në nenin 8 të këtij projektligji është përcaktuar se një nga mënyrat e identifikimit të projekteve do të mbeten propozimet e pakërkuara nga operatorët ekonomikë por vetëm për realizimin e punimeve dhe/ose ofrimin e shërbimeve në porte, aeroporte, për prodhimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike, energjisë për ngrohje dhe shpërndarjen e gazit natyror.

Në nenin 9 të këtij projektligji është parashikuar faza kur autoritetet kontraktuese duhet të paraqesin për vlerësim dhe miratim paraprakisht nga pikëpamja e implikimeve fiskale, individuale apo në grup për shpenzimet buxhetore, deficitin buxhetor, qëndrueshmërinë e borxhit publik dhe detyrimet kontingjente eventuale të gjithë projektet e koncesionit/partneritetit publik privat. Gjithashtu, ky detyrim parashikohet dhe për çdo ndryshim të studimit të fizibilitetit.

Në nenin 10 të këtij projektligji është parashikuar se partnerët privatë nuk do të kenë më mundësinë e zhvillimit të projekteve të koncesionit/PPP në formën e

propozimeve të pakërkua, pranë autoriteteve kontraktuese. Përjashtim nga ky parashikim bëjnë vetëm projektet në fushën e energjisë elektrike, portet dhe aeroportet pasi konsiderohen si sektorë strategjikë për të cilët vendi ka ende nevojë për investime dhe përvojën e sektorit privat.

Një tjetër parashikim i këtij neni është dhe shfuqizimi i sistemit të shpërblimit të propozuesit të pakërkuar me pikë bonus. Pas hyrjes në fuqi të kësaj dispozite në datën 1 korrik 2019, sistemi i shpërblimit me pikë bonus do të zëvendësohet me mekanizmin e shpërblimit të shpenzimeve të kryera nga propozuesi i pakërkuar për hartimin e studimit të fizibilitetit. Konkretisht, është parashikuar se pas përfundimit të procedurës konkurruese në rastin e propozimeve të pakërkua nëse nga klasifikimi rezulton se propozuesi i pakërkuar nuk është shpallur fitues, atëherë i lind e drejta e kompensimit për shpenzimet e kryera për përgatitjen e studimit të fizibilitetit. Vlera e kompensimit do të jetë jo më e madhe se 1% e vlerës së investimit të propozuar. Ky proces nuk cenon konkurrencën dhe nuk avantazhon propozuesin e pakërkuar, por e kompenson atë për shpenzimet e kryera për përgatitjen e propozimit.

Në nenin 11 të këtij projektligji është parashikuar detyrimi i të gjitha autoriteteve kontraktuese për të dërguar për vlerësim pranë ministrisë përgjegjëse për financat, kontratën e koncesionit/PPP, pas përfundimit të negociimit të saj. Në rastin e kontratave me mbështetje financiare dhe që marrin përsipër risqe fiskale, pas vlerësimit nga ministria përgjegjëse për financat do të miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Ky ndryshim bëhet me qëllim mbajtjen nën kontroll të diversifikimit të riskut të mbajtur midis palëve, gjatë gjithë ecurisë së projektit duke mos ndryshuar gjatë fazës së negociimit angazhimet e parashikuara në studimin e fizibilitetit.

Në nenin 12 të këtij projektligji është parashikuar se sigurimi i kontratës së koncesionit/PPP përcaktohet nga autoritetet kontraktuese deri në masën 5% të vlerës së kontratës dhe mund të reduktohet në mënyrë përpjesëtimore gjatë ekzekutimit të saj, por, në asnjë rast, gjatë kohëzgjatjes së saj nuk mund të jetë më e vogël se 25% e vlerës fillestare të sigurimit.

Në nenin 13 të këtij projektligji është parashikuar se projektet e koncesionit/PPP të zhvilluara në fushën e sportit do të përjashtohen nga detyrimi për pagesën e tarifës së koncesionit me qëllim nxitjen e projekteve në këtë sektor i cili po has vështirësi në realizimin e projekteve për shkak të leverdisshmërisë së ulët që kanë. Gjithashtu, në këtë nen është parashikuar edhe mekanizmi i arkëtimit të tarifave koncesionare, nëpërmjet urdhrit të ministrit përgjegjës për financat kur nuk paguhen brenda afateve ligjore nga koncesionarët.

Në nenin 14 të këtij projektligji është parashikuar se për çdo ndryshim të kontratave të koncesionit/PPP do të ndiqet e njëjta procedurë për miratimin e

tyre në ministrinë përgjegjëse për financat dhe në rastin e kontratave me mbështetje buxhetore do të miratohen edhe nga Këshilli i Ministrave.

Në nenin 15 të këtij projektligji është parashikuar se çdo transferim i kontratës së koncesionit/PPP do t'i nënshtrohet procedurës për miratim paraprak nga ministria përgjegjëse për financat dhe nëse kontrata e koncesionit/PPP parashikon mbështetje financiare, atëherë dërgohet për miratim edhe pranë Këshillit të Ministrave.

Në nenin 16 të këtij projektligji është parashikuar shfuqizimi i nenit 42, të ligjit për shkak të riformulimit të kompetencave të ministrisë përgjegjëse për financat në nenet e tjera.

Në nenin 17 të këtij projektligji është parashikuar hyrja në fuqi e dispozitave mbi propozimet e pakërkuara dhe shfuqizimin e sistemit të bonusit në datën 1 korrik 2019 si dhe detyrimi për të nxjerrë akte nënligjore.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Për zbatimin e këtij akti ngarkohen të gjitha organet dhe institucionet e pushtetit qendror dhe vendor.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektligj është hartuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky ligj nuk ka ndikim në buxhet.

KËSHILLI I MINISTRAVE